



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1652
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 17.05.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.32

Datë 10.05.2022

**“Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022,
Bashkia Dibër ”.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

.....
Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. & fax. 00355 218 229 37

Relacion shpjegues për miratimin e "Furnizim vendosje sinjalistike vertikale"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronja k, "miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik" si dhe duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022, në buxhetin e bashkisë Dibër është planifikuar nga drejtoria e shërbimeve publike "Furnizim dhe vendosje sinjalistike horizontale" me vlerë 700,000 lekë dhe kërkojnë që të bëhet ndryshimi në blerje "Furnizim vendosje sinjalistike vertikale" pasi është e nevojshme kjo ndërhyrje në infrastrukturë.

Përgjegjësi Sektorit Juridik
Elona Lusha

Drejtor i Ekonomik
Lorenc Cibaku

Përgjegjëse Finance
Mensur Shehi



1652
20/05/22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.451/1.prot.

Peshkopi, më 19.05.2022

Lënda : Per vendimin nr. 32, datë 10.05.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Diber nr.32, date 10.05.2022 "Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022 Bashkia Dibër", vendosa :

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to dhe respektimit të disiplinës financiare, veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-vendime të kësaj natyre.

PREFEKTI
Nexhbedin SHIHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 32 Datë 10/05/2022

**“Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022,
Bashkia Dibër”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022, Këshilli Bashkiak ne mbledhjen e datës 10.05.2022 me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

Vendosi:

- I. Miratimin e ndryshimit të zërit të fondit të financimit për shpenzimin e planifikuar “Furnizim vendosje sinjalistike horizontale” si më poshtë:
- II. Të pakësohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. 1 Art. 602 700,000 lekë e planifikuar për ” Furnizim vendosje sinjalistike horizontale”

Të shtohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. 1 Art. 602 700,000 lekë për ” Furnizim vendosje sinjalistike vertikale”
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT - VENDIM

Nr. 9 Datë 10/05/2022

**“Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022,
Bashkia Dibër”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022:

Kërkojmë:

- I. Miratimin e ndryshimit të zërit të fondit të financimit për shpenzimin e planifikuar “Furnizim vendosje sinjalistike horizontale” si më poshtë:
- II. Të pakësohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. I Art. 602 700,000 lekë e planifikuar për ” Furnizim vendosje sinjalistike horizontale”

Të shtohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. I Art. 602 700,000 lekë për ” Furnizim vendosje sinjalistike vertikale”
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse sektorit Juridik
Elona Lusha

Drejtori i Shërbimeve Publike
Agron Cara

Përgjegjëse Finance
Mensur Shehi

Drejtor Ekonomik
Lorenc Çbaku

